NURİ PAKDİL

PËRKUSHTIMI

ESE

BOTIMET TOENA

NURİ PAKDİL

PËRKUSHTIMI

Përktheu nga origjinali turqisht
dr. Joana RUÇI

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2026

Autori: NURİ PAKDİL
Titulli në origjinal: Bağlanma
Botuar në turqisht nga Edebiyat Dergisi Yayınları, 1979

Instituti Yunus Emre sponsorizoi përkthimin dhe botimin e këtij libri.

YUNUS EMRE ENSTITÜSÜ

Botuese: Irena Toçi

Redaktore letrare: Verzana Nikshiqi
Korrektore letrare: Anjeza Hoda
Përkujdesja grafike: Rogen Alushani
Kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 9789928961044

© Ketebe Kitap ve Dergi Yayıncılığı Anonim Şirketi
2026 via İntrotema Literary Agency
© në shqip BOTIMET TOENA

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA
Rr. "M. Gjollesha", nr. 71, Tiranë 1023
ose K. Postare 1420
Tel.: +355 67 70 70 884
botimet.toena@gmail.com
toena.porosionline@gmail.com
https://toena.al

Me nderim të pafund për kujtimin
e Fethi Gemuhluoğlu

TË ECËSH ME KOHËN

Ishin vitet kur studioja në universitet në Stamboll. Tani shpesh mendoj se nga kush e dëgjova për herë të parë emrin e tij. Ku e dëgjova? Në universitet, në konviktet apo shtëpitë ku qëndroja, në rrugë, në ndonjë kafene apo restorant? Besoj se ishte fillimi i vitit 1959 kur e dëgjova për herë të parë emrin e tij. E thërrisnin "Fethi Agabeu". Flisnin për të. Interesi im po rritej gradualisht. (Tek unë, interesi ndaj dikujt që nuk e kam parë kurrë, formësohet ngadalë. Nuk mund ta dalloj se si krijohet kjo. Është një grumbullim që arrin shumë vonë në pikën e shpërthimit dhe më lind dëshira të shkoj

ta takoj). Këtë herë nuk po ndodhte kështu. Doja të shkoja ta shihja menjëherë. Ato që thuheshin për të, më magjepsnin. Kisha mësuar vendin ku punonte. Si do të arrija tek ai, çfarë do t'i thoja? Si do të më priste? Shkova. E pashë në vendin ku punonte. Ai ishte ulur në tavolinë dhe dhoma e tij ishte e mbushur plot me mysafirë. (Vetëm nga dritarja kisha mundur të shikoja brenda). Shkoja shpesh, shikoja nga dritarja, vëzhgoja brenda dhe kthehesha. Nuk po arrija të merrja guximin për të hyrë brenda dhe për t'u njohur me të. U tregoja shokëve të universitetit për emocionet e forta që më vlonin brenda. "Hyr brenda, njihu", më thonin. Mendoj se kështu kaloi një vit. Ishte një mbrëmje pranvere. (Këtë e mbaj mend shumë mirë). Të gjithë guximin tim e vesha si një armë dhe shkova. Përsëri kishte disa njerëz brenda. Kur e pashë nga aq afër, menjëherë ndjeva sikur një univers u mbush brenda meje. (Unë, deri tani, shumë pak njerëz kur i kam parë nga afër, më kanë shkaktuar ndjenja të tilla. Shumë pak njerëz). Një fuqi misterioze më pushtoi. Kjo nuk do të thotë humbje e lirisë. Përkundrazi, në një madhështi të tillë njeriu bëhet i vetëdijshëm për të. Ndërtesa ku ndodhej ishte "Sarajet Sergi".

Përpara kësaj ndërtese ishte një kopsht për çaj. Zbritëm në kopsht dhe pimë çaj. (Ai çaj është një nga çajrat që nuk e kam harruar kurrë). Po atë verë shkova disa herë për ta parë. (Vera e vitit 1960 ishte shumë e trazuar, paksa edhe e mallkuar për mua). Një natë, në Cağaloğlu ndaluam për një gazetë, prej andej zbritëm në Sirkeci dhe duke kaluar nga Eminönü, përmes Urës së Galatës, ecëm deri tek Kadıköy Pier. (Besoj se në ato vite banonte në Göztepe). Ky nuk ishte një takim i mirëfilltë, pa dyshim. Ishte thjesht një dëgjesë, një shërim i brendshëm. (Ai që fliste me Të, më saktë, ai që thjesht e dëgjonte Atë, kur largohej prej Tij, patjetër ndiente se mekanizmat e tij të brendshëm, në një farë mënyre, ishin rregulluar dhe riparuar). Ai ishte një mjeshtër i madh i shërimit të zemrës së njeriut dhe i plagëve shpirtërore të tij. (Nga fundi i asaj vere deri në pranverën e vitit 1961 qëndrova në Maraş). I shprehja respektet e mia përmes letrave. Më përgjigjej me karta të vogla, të bardha. (Në të gjitha këto karta më porosiste të shkruaja). Erdha në Stamboll për të dhënë provimin e fundit në fakultet. Për rrugë ndalesha tek ai; e dëgjoja, vazhdimisht e dëgjoja (ndërsa fliste, sikur ju merrte me vete dhe ecte

drejt një qëllimi). Atë verë u ktheva sërish në Maraş, pastaj shkova ushtar. (Duket sikur nuk e kisha parë kurrë gjatë kohës së shkollës në Tuzla? Mendoj se ka qenë kështu). Nga mesi i vitit 1962 deri në fund të vitit 1963, edhe pse jo deri në fund të vitit, qëndrova në Bitlis për shërbimin ushtarak. (Shumë e çuditshme, nuk mund të merrja asnjë lajm). Ishte fundi i vitit 1962, me shumë gjasa kështu ishte, kur një ditë pashë në një gazetë një foto të tij duke zbritur nga shkallët e avionit. Po shkonte në Gjermani. Nuk kishte kaluar shumë kohë kur erdhi një letër nga Gjermania. (Duke u ndalur mbi funksionin universal të artit dhe letërsisë, përsëri më porosiste të shkruaja). Unë, nga ana ime, sa munda, e mbaja rregullisht këtë gëzim të dërgimit të letrave. Në vitin 1964 isha në Stamboll dhe redaktoja një faqe arti në një revistë javore. (Zgjati shumë pak kjo). Këtë revistë gjithashtu e dërgoja në Gjermani së bashku me letrat e mia. Në një nga letrat e tij, ardhja e të cilave më nderonin, më porosiste të nxirrja një revistë arti dhe të mblidheshim me disa shokë rreth kësaj reviste. (Fara e një reviste letrare, ndoshta, u mboll brenda meje në vitin 1964). Me letrat e tij më nxiste vazhdimisht.

Në kohën tonë, më shumë se çdo gjë tjetër, kishim nevojë për inkurajim. Në pranverën e vitit 1965, ai erdhi nga Gjermania në Ankara. Ishte në Ministrinë e Arsimit. Për shkak të fatit historik, edhe unë tashmë gjendesha në Ankara. (Qëndrimi i tij i vazhdueshëm në Ankara zgjati për një farë periudhe deri në vitin 1967). Shkoja shpesh ta shihja. Natën, ose ishim në shtëpinë e tij, ose në kopshtin e çajit të Parkut Gençlik që e quanim "Söğüt". Ishte shumë i qetë atje. Ose në hotelin ku qëndronte, në vitin 1967 dhe vitet pasuese, kur vinte nga Stambolli. Ose në pastiçeritë në Kızılay. Tani nuk ka mbetur asnjë, janë shembur. Ose në kafenenë rreth Hacı Bayramit. Zakonisht shumica shkonim bashkë dhe menjëherë formonim një hark përreth tij. Ai theksonte se çdo kthesë që duhej kapërcyer: me qëndresë. Ngrohtësia universale që ofronte vinte nga besimi në Zot dhe nga përkushtimi ndaj Profetit; ishte gëzim miqësie. Ai e mbante përdore njeriun dhe e mësonte të ecte përgjatë dritës. Njeriu ndiente se rritej dhe shumëfishohej pranë Tij.